



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafit 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/2019) dhe nenit 40 paragrafi 3 të Rregullores së Punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsioni, Duke vepruar sipas lëndës së formuar pas denoncimit të paraqitur nga një parashtrues i panjohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK) në seancën e 74-të të mbajtur më 05.09.2022 ka miratuar sa vijon

### VENDIM

Procedura sipas lëndës me nr.12-1766/1 të datës 04.05.2021, me pretendime ndaj këshilltarit të Komunës----- në lidhje me ndërtimin pa leje të një objekti në cilësinë e investitorit, **NDËRPRITET.**

KSHPK vërtetoi se në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave , nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm për arsye se pohimet nga denoncimi nuk janë vërtetuar.

Lënda me numër 12-1766/1 të datës 04.05.2021 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

### Arsyetim

Më datë 05.04.2021, një parashtrues i panjohur ka dorëzuar denoncim me pretendime kundër Këshilltarit të Komunës ----- në lidhje me ndërtimin pa leje të objektit në cilësinë e investitorit dhe u formua lënda me numër 12-1766/1 të datës 04.05.2021.

Në denoncim parashtruesi thekson se këshilltari i Komunës----- , ----- , e keqpërdori detyrën e saj politike në një mënyrë që ndërtoi një ndërtesë në kundërshtim me pullën e lëshuar të ndërtimit. Objekti dilte në një zonë publike dhe uzurponte trotuarin e rrugës.

Me qëllim të verifikimit të pretendimeve dhe konstatimit të gjendjes faktike me rastin e denoncuar, KSHPK-ja ka dorëzuar kërkesë për mbledhjen e informacionit në Komunë ----- inspektor i autorizuar i ndërtimit.

Nga inspektimi i kryer nga njoftimi i dorëzuar i Komunës -----

----- u konstatua si më poshtë:

- Me datë 11.03.2022, inspektori ndërtimor komunal ka kryer inspektim në subjektin e mbikëqyrjes ----- dhe ----- në lidhje me ndërtimin e objektit afarist banesor në PK Nr.----- e regjistruar në Listën Pasurore nr.----- për KK ----- me të drejtën e bashkëpronësisë së ----- dhe ----- me pjesë posedimi prej ½ secili.

- Ndërtimi i objektit gjatë inspektimit ishte në fazën përfundimtare, pra ishte në proces ndërtimi të fasadës.

- Inspektorit gjatë kontrollit i janë ofruar për inspektim këto dokumente: leje ndërtimi; projekti bazë, vendimi për miratimin e ndryshimeve gjatë ndërtimit dhe projekti për ndryshimet gjatë ndërtimit.

- Gjatë vetë inspektimit, subjektet e mbikëqyrjes bënë me dije se me urdhër të PTHP-së ----- është kryer rievimi i objektit nga Agjencia e Kadastrës së Patundshmërisë i Republikës së Maqedonisë së Veriut, për shkak të kallëzimit penal për uzurpim të pronës shtetërore, e cila ankesë nga ----- u refuzua sepse nuk u konstatuan parregullsi.

- Në bazë të gjendjes faktike të konstatuar, inspektori kompetent nuk ka konstatuar parregullsi në lëndën e mbikëqyrjes, për këtë arsye në pajtim me nenin 83 paragrafi 5 të Ligjit për mbikëqyrjen inspektuese ("Gazeta Zyrtare e RM-së". "Nr. 102/2019), ka ndërprerë procedurën.

Duke pasur parasysh sa më sipër, KSHPK vlerësoi se pretendimet nuk janë vërtetuar për çka nuk ka elemente për veprime të mëtutjeshme dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Përgatiti: B.K.SH

Miratoi: M.r .SH.S, Anëtar i KSHPK-së

KOMISIONI SHTETËRORË  
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT

Kryetare,  
Biljana Ivanovska